



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 298/Prot.
3

Tiranë, më 05/05/2015

VENDIM
“ Për rrëzimin e ankesës”

Nr. 31, datë 05/05/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/Qendra “Res Publica” ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën Nr. 298 Prot., datë 09.04.2015, ndaj Inspektoratit Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit (IKMT), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit”. Ankuesi/ Qendra “Res Publica” me kërkesën nr. 021/1Prot., datë 06.03.2015, me objekt “Kërkesë për informacion”, ka kërkuar kopje të Vendimit nr.23, datë 25.08.2014, për prishjen e ndërtesës në “Rrugën e Elbasanit”.

Komisioneri me urdhrin nr.80, datë 15.04.2015, urdhëroi kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik/ Inspektoratit Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit. Gjatë inspektimit u konstatua se në protokollin e IKMT nuk rezultoi të jetë depozituar kërkesa e Qendrës “Res Publica”. Në këto kushte pretendimi i ankuesit për refuzim dhënie informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare nuk qëndron.

Përfundimisht ankesa rezultoi e pa bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 298 Prot., datë 09.04.2015 të Qendrës “Res Publica”, ndaj Inspektoratit Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit.
2. Kundër këtij vendimi ankuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u dha sot në datë 05.05.2015.

